



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I JASHTËM I VLERËSIMIT

Nr. 11/186 Prot

Tiranë, më 21.02.2020

V E N D I M
Nr. 9 datë 07.02.2020

Trupa e vlerësimit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, e përbërë nga:

Mirela Ujkani (Miti)	Kryesuese
Alban Laska	Relator
Artur Baku	Anëtar

asistuar nga anëtari i sekretariatit teknik, Esmir Rringa, më datë 07.02.2020 ora 9:45, në Tiranë, në Pallatin e Koncerteve, (*Ish –Pallati i Kongreseve*), salla B, kati 0 mori në shqyrtim në seancë dëgjimore që i përket:

SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT: **Ardi Zenel Veliu**, datëlindje 19.01.1971, me funksion Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

OBJEKTI: **Vlerësimi kalimtar** i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji Nr. 12/2018**, “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*”, i ndryshuar,
Ligji nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”,
Ligji nr. 49/2012 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË KOMISIONIT TË JASHTËM TË VLERËSIMIT,

pasi dëgjoji gjetjet bazuar në arsyetimin ligjor si dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, Alban Laska, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoji subjektin e vlerësimit Ardi Veliu, i cili në seancë dëgjimore publike deklaroi se do të respektonte vendimin e trupës; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të Ligjit nr.12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit është organi kompetent që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në Ligjin nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar, shtetasi Ardi Zenel Veliu është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 3.6.2019 si *“Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit”*.
3. Subjekti i vlerësimit, Ardi Veliu, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 3.6.2019, nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit në përputhje me Rregulloren *“Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit”*.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga Alban Laska Relator, Mirela Ujkani (Miti) Kryesuese dhe Artur Baku Anëtar.
5. Trupa e vlerësimit në përputhje me Ligjin 12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores së Brendshme të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit miratuar me Vendimin nr.17, datë 31.5.2019 *“Për Hapat Procedurale të Unifikuar gjatë Vlerësimit të Subjekteve nga Trupa e Vlerësimit”*, me Vendimin nr.1, datë 17.6.2019, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Ardi Zenel Veliu.
6. Relatori i çështjes, Alban Laska, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 20.6.2019 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në KJV në datën 24.6.2019 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara Ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

- 10.** Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
- a) vlerësimin e pasurisë; b) kontrollin e figurës; c) vlerësimin e aftësive profesionale.*
- 11.** Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në Ligjin 12/2018 i ndryshuar, Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në Ministrinë e Brendshme që janë:
- *Deklarata e Pasurisë,*
 - *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
 - *Formulari i Vetëvlerësimit Profesional,*
 - *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklarinimet,*
 - *provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.*
 - *provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.*
 - *ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gadishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*
- 12.** Trupa e vlerësimit në datën 6.1.2020 pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Ardi Veliu, me Vendimin nr.2, datë 6.1.2020, vendosi;
- a) Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Ardi Veliu;*
- b) Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:*
- *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
- c) Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.*
- 13.** Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.
- 14.** Në datën 30.1.2020, trupa e vlerësimit, njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 6 shkurt 2020, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, (Ish –Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit, Ardi Velu, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të përfaqësohet vetëm. Subjekti parashtrori disa shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e vlerësimit në tërësi të kryer ndaj tij. *(të pasqyruara në procesverbalin e seancës dëgjimore).*

Në fund të seancës dëgjimore datë 6.02.2020, subjekti i vlerësimit, Ardi Velu deklaroi se do pranoj çdo vendim të komisionit. Më datën 7.02.2020, Trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Me subjektin e vlerësimit, është komunikuar me anë të postës elektronike duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave.

Subjekti i vlerësimi Ardi Velu ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjithë fazave të hetimit.

IV - VLERËSIMI KALIMTAR

A. VLERËSIMI I PASURISË

Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “*Vlerësimi i pasurisë*”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.

Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Ardi Velu ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 30.4.2018, brenda afateve ligjore. Formulari i Pasurisë ka nr. *** index, viti 2018.

Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.

Gjithashtu Komisioni ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, shpjegimet e subjekti për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare.

Subjekti i vlerësimit Ardi Veliu, për shkak të funksionit të tij si: Specialist Kontrolli të Shërbimeve në Policinë Berat në vitin 2004, si Shef Komisarariatit të Policisë Durrës në vitin 2013, si Zv.Drejtor për Sigurinë në Drejtorinë e Policisë Tiranë në vitin 2014, si Drejtor i Shkollës së Policisë në Akademinë e Sigurisë në vitin 2015, si Drejtor i Drejtorisë së Policisë Rrugore në vitin 2016, si Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë në vitin 2017 dhe si Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit në vitin 2018 e në vijim, ka qenë dhe është subjekt deklarues në ILDKPKI. në bazë të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, *i ndryshuar*.

Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

Hetimi administrativ konsistoi në:

- *verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;*
- *në verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;*
- *në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;*
- *në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.*

DEKLARIMI I PASURISË

Subjekti i vlerësimit në deklaratën e pasurisë, dorëzuar në datën 30.4.2018, në zbatim të Ligjit nr.12/2018, ka deklaruar;

1. Depozitë në Bankën Kombëtare Tregtare, me gjendje në datën 30.4.2018, në vlerën 740.717 lekë. Zotërimi 100%.

Burimi i të ardhurave nga kursimet ndër vite dhe nga interesat bankare.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë aset.

1.1 Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr.****prot, dt. 23.7.2019 konfirmon se Ardi Veliu ka disponuar deri në dt. 30.4.2018, depozitë me vlerë 735.569 lekë. Në dt. 31.12.2017 depozita ka qenë me vlerë 740.717 lekë. Kjo depozitë është hapur në maj të vitit 2016. Diferanca prej 5148 lekë ka ardhur si pasojë e komisioneve të bankës.

1.2 ILDKPKI, me shkresën nr.****prot, dt. 21.6.2019 informon se subjekti i vlerësimit ka deklaruar krijimin e këtij asemi në vitin 2016, në vlerën 730.608 lekë, në vitin 2017 është deklaruar në vlerën 740.717 lekë.

1.3 Nga analiza financiare e realizuar për subjektin e vlerësimit konstatohet se burim për krijimin e këtij asemi kanë shërbyer të ardhurat nga paga.

Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se:

- ✓ ***Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e Bankës Kombëtare Tregtare.***
- ✓ ***Burimi financiar për krijimin të depozitës është i ligjshëm.***

2. Depozitë në bankën Credins, me gjendje në datë 30.4.2018, në vlerën 5.000 euro. Zotërimi 100%. E krijuar më datë 17.11.2017.

Burimi i të ardhurave nga shitja e automjetit me datë 16.11.2017, me kontratë nr.***rep, nr.***kol, datë 16.11.2017.

*Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës “Kontratë Shtiblerje autoveture, nr.***rep, nr.***kol, dt. 16.11.2017, shitës Ardi Veliu dhe blerës shtetasi Q.B, për automjetin me targa AA****, në vlerën 5000 euro.*

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë aset.

- 2.1 **Banka Credins**, me shkresën nr.***prot, dt. 22.8.2019, konfirmon se Ardi Veliu disponon llogari rrjedhëse, me gjendje në dt. 30.4.2018, në vlerën 4.994 euro.
- 2.2 **DPSHTRR**, me shkresën nr.***/*prot, dt. 2.7.2019, konfirmon se Ardi Veliu nuk ka të regjistruar automjet në pronësinë e tij.
- 2.3 **Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë**, me shkresën nr.***/*prot, dt. 1.7.2019, konfirmon se nga regjistri elektronik i noterëve rezulton veprimi noterial “Kontratë shitblerje me nr.***rep. nr.***kol, dt. 16.11.2017.

Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se:

- ✓ **Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e institucioneve të specializuara.**
- ✓ **Burimi financiar i krijimit të depozitës është i ligjshëm.**

3. **Llogari** page në Bankën Credins, me gjendje në datë 30.4.2018, në vlerën 190.000 lekë. Zotërimi 100%.

Burimi i të ardhurave nga paga.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë aset.

- 3.1 **Banka Credins**, me shkresën nr.***/*prot, dt. 22.8.2019 konfirmon se Ardi Veliu disponon llogari page, me gjendje në dt. 30.4.2018, në vlerën 201.921 lekë. Diferenca prej 11.921 lekë ka ardhur si pasoj e një shpërblimi.
- 3.2 Si burim kryesor kanë shërbyer të ardhurat e pagës të cilat janë kredituar në bankën Credins që prej vitit 2017 e në vijim.
- 3.3 Nga analiza financiare e realizuar për subjektin e vlerësimit konstatohet se burim për krijimin e këtij asemi kanë shërbyer të ardhurat nga paga.

Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se për këtë aset:

- ✓ **Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e bankës Credins.**
- ✓ **Burimi financiar i krijimit të llogarisë është i ligjshëm.**

4. **Pasuri e paluajtshme**, apartament banimi, pronotuar në datë 23.11.2017, me sipërfaqe 221 m2, ku është përfshirë sipërfaqja e banimit, sipërfaqe e verandës dhe sipërfaqet e përbashkëta, me adresë: Rr.***, nr.*, Komuna Farkë, Tiranë. Vlera 79.703 euro.

Burimi i të ardhurave për pronotimin e apartamentit të banimit është kredi e marrë në bankën Credins, në shumën 5.000.000 lekë dhe të ardhura nga paga. Likuidimi do të bëhet me këste, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Bashkëpronësia është e pandarë me bashkëshorten.

*Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: “Kontratën për ndërtim apartamenti, me nr.***rep, nr.***kol, dt. 23.11.2017, porositës Ardi dhe M.Veliu dhe sipërmarrës shoqëria “***”shpk, për apartament në vlerën 79.703 euro, Kontratës Kredie me bankën Credins, nr.***rep, nr.***kol, dt. 12.12.2017 dhe Kontratë Qiraje, nr.***rep, nr.***kol, dt. 13.7.2017, qeramarrës z. Ardi Veliu dhe*

qeradhënës shtetasi H.A, për apartament, ndodhur në Tiranë, në vlerën 20.000 lekë/muaj, me afat 2 vjet.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri të paluajtshme.

4.1 ILDKPKI, me shkresën nr. ****prot, dt. 21.6.2019 informon se subjekti ka deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave private të vitit 2017, pronotimin e apartamentit në vlerën 79.703 euro, gjithashtu kredinë e marrë dhe detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit.

4.2 Subjekti i vlerësimit është pyetur nga komisioni në proces verbalin e mbajtur dt. 10.7.2019, për pronotimin e apartamentit, konkretisht për pagesat e kryera nga momenti i dorëzimit të deklaratës deri në dt. 10.7.2019, sa është detyrimi i mbetur, mbi ç'baza është përcaktuar vlera prej 79.703 euro si dhe nëse ky ndërtim ka përfunduar apo jo.

4.3 Subjekti i vlerësimit ka deklaruar se shoqërisë i janë kryer 4 pagesa nëpërmjet sistemit bankar, dt. 21.12.2017 shuma 37.537 euro (me burim kredinë e marrë në Credins Bank në vlerën 5.000.000 lekë), dt. 13.4.2018 shuma 8000 euro dhe në dt. 12.4.2019 shuma 5900 euro dhe 5500 euro, kaluar nëpërmjet sistemit bankar në bankat BKT dhe Credins.

*Në lidhje me metodologjinë e përlllogaritjes nga shoqëria "****"shpk, ka paraqitur një relacion shpjegues me nr. ****prot, dt. 9.7.2019 i dalë nga shoqëria e ndërtimit "****"shpk dhe nënshkruar nga administratori saj shtetasi A.Ç, ku shpjegohet mbi kontratën e porosisë nr. ***rep, nr. ****kol, dt. 23.11.2017 se, apartamenti i porositur me sipërfaqe totale ndërtimore prej 221 m2, ka të përfshirë dhe aksesoret e tij, verandë si dhe kuota e pjesëmarrjes në bashkëpronësinë e detyrueshme, e cila është me sip. 23.6 m2, e evidentuar qartësisht në planimetri. Apartamenti me nr. ***, objekt kontratë, është i llojit dubleks me ndërkat – Mexanin, me sip. 107.8 m2 në katin e parë dhe 34 m2 sipërfaqja e ndërkatit Mexanin. Apartamenti ka në shfrytëzim edhe verandë me sip. 55 m2. Çmimi është ndërtuar vetëm për elementët individual të pronësisë duke marrë në analizë dhe karakteristikat teknike që ato kanë dhe mbi këto baza kanë përcaktuar çmimin për apartamentin 497 euro/m2 të sipërfaqes neto prej 141.8 m2 si dhe 165 euro/m2 për verandën me sip. 55 m2, për rrjedhojë çmimi në total ka rezultuar në 79.703 euro. Pjesëmarrja në bashkëpronësinë e detyrueshme – sipërfaqja prej 23.6m2 nuk është objekt transaksioni, kjo bashkëpronësi ju buron nga ligji-blerja e njësisë individuale nr. ***, bazuar dispozitave për bashkëpronësinë në tërësi të Kodit Civil. Me regjistrimin përfundimtar të objektit pranë ARSH Tiranë, certifikata për vërtetim pronësie në favorin e porositësve do të paraqes informacionin pronësor me këto të dhëna: Titull i pronësisë – Apartament me sip. 107.8 m2 dhe në kartelën e pasurisë në seksionin Kondicionet e Veçanta do të gjejnë pasqyrimin: Sipërfaqe ndërkat Mexanin 34 m2 dhe sip. verandë 55 m2.*

Subjekti deklaron se apartamenti nuk ka përfunduar akoma.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklarimeve edhe dokumenta justifikues "deklaratë bankare" për transaksionet.

4.4 Komisioni i ka dërguar shkresë shoqërisë së ndërtimit me nr. ****prot, dt. 16.9.2019 për të verifikuar përputhshmërinë e deklarimeve të subjektit.

Shoqëria e ndërtimit "**" shpk**, me shkresën nr. ****prot, dt. 25.9.2019, në përgjigje të shkresës tonë me objekt "kërkim të dhënash për procesin e vlerësimit" na bën me dije se:

Bazuar kontratës për ndërtim apartamenti, apartamenti është i llojit dubleks, me ndërkat-Mexanin të përfuara, me sipërfaqe individuale në katin e parë prej 107.8 m2 dhe sipërfaqe të ndërkatit mexanin prej 34 m2, në të cilën janë përfshirë sip. neto apartamenti 141.8 m2 dhe

aksesorët, verandë me sip. 55 m2 si dhe pjesa e përbashkët e detyrueshme me sip. 23.6 m2, në total përbëhet në sip. 221 m2.

Çmimi i porosisë apartament është 79.703 euro dhe pagesat e kryera nga z. Ardi Veliu dhe bashkëshortja e tij janë si më poshtë vijon:

Vlera prej 37.537 euro, është paguar në Credins Bank në dt. 21.12.2017.

Vlera prej 8000 euro është paguar në BKT, dt. 13.4.2018.

Vlera prej 5900 euro është paguar në BKT Bank, në dt. 12.4.2019.

Vlera prej 5500 euro është paguar në Credins Bank, në dt. 12.4.2019.

Detyrimi i mbetur për tu paguar është 22.765 euro, i cili sipas kontratës do të paguhet nga blerësi me daljen e certifikatës së pronësisë.

Nga ana komisionit, shoqërisë i janë kërkuar kontratat e porosisë për klient të ndryshëm, të cilët kanë pronotuar në të njëjtin objekt me subjektin e vlerësimit, dhe ka rezultuar se nga kontratat e paraqitura nga shoqëria, vlera dhe kushtet e kontratës janë të ngjashme me atë të subjektit të vlerësimit.

4.5 Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr.*prot, dt. 23.7.2019, konfirmon se Ardi Veliu në dt. 12.4.2019 ka kaluar shumën prej 5900 euro në favor të shoqërisë “*****” shpk, ndërsa znj. M.Veliu në dt. 13.4.2018 ka kaluar shumën 1.039.200 lekë e konvertuar valutë të huaj 8000 euro, në favor të shoqërisë së ndërtimit “*****” shpk, për blerjen e apartamentit sipas kontratës nr.***rep, nr.***kol, dt. 23.11.2017, shlyerje pjesore e detyrimit).**

4.6 Banka Credins, me shkresën nr.*/*prot, dt. 22.8.2019 konfirmon se Ardi Veliu në dt. 12.4.2019 ka kaluar shumën 5500 euro për “Këst Blerje Shtëpie për shoqërinë “*****” shpk”.**

4.7 Agjensia Shtetërore e Kadastrës Tiranë, me shkresën nr. **/*prot, dt. 18.12.2017 konfirmon se Ardi Veliu dhe M.Veliu nuk disponojnë pasuri të paluajtshme të regjistruar në pronësinë e tyre, gjithashtu nuk janë persona të cilët kanë aplikuar për procedure legalizimi të ndonjë objekti informal.

4.8 Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, me shkresën nr.*/*prot, dt. 1.7.2019 konfirmon se nga regjistri elektronik i noterëve rezulton kryerja e kontratës për ndërtim apartamenti me nr.***rep, nr.***kol, dt. 23.11.2017, kryerja e kontratës së kredisë nr.***rep, nr.***kol, dt. 12.12.2017 dhe kontratë qeraje nr.***rep, nr.***kol, dt. 13.7.2017.**

4.9 OSHEE, me shkresën nr.*/*prot, dt. 9.8.2019 konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë të regjistruar kontratë për shërbim energjie, në instancën e qarkut Tiranë.**

4.10 UKT, me shkresën nr.*-*/*prot, dt. 9.7.2019 konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë të regjistruar kontratë për shërbim ujësjellës kanalizime.**

4.11 Komisioni hetoi në lidhje me mundësitë financiare dhe nga analiza e të ardhurave rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë patur burim financiar të mjaftueshëm për të përballuar pagesat e deri tanishme për blerjen e apartamentit.

Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se për këtë aset:

- ✓ **Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e institucioneve të specializuara.**
- ✓ **Burimi financiar që ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme është i ligjshëm.**
- ✓ **Subjekti i vlerësimit nuk ka kryer fshehje të pasurisë.**

Bashkëshortja e subjektit të vlerësimit M.Veliu në deklaratën e pasurisë, dorëzuar në datën 30.4.2018, në zbatim të Ligjit nr.12/2018 ka deklaruar;

5. Depozitë në IntesaSanPaolo Bankë, me gjendje në datë 30.4.2018, në vlerën 803.841 lekë. Zotërimi 100%.

Burimi i të ardhurave janë kursimet nga paga.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë aset.

5.1 ILDKPKI, me shkresën nr.****prot, dt. 21.6.2019 ka sjell informacion se subjekti e ka deklaruar këtë aset në deklaratën e interesave private në vitin e krijimit të këtij asemi (vitin 2013) në vlerën 400.00 lekë, në vitin 2017 është deklaruar në vlerën 803.841 lekë.

5.2 Banka IntesaSanPaolo, me shkresën nr.**/****/*prot, dt. 4.7.2019, konfirmon se M.Veliu disponon deponitë, me gjendje në dt. 30.4.2018 në vlerën 800.000 lekë.

5.3 Komisioni hetoi në lidhje me mundësitë financiare dhe nga analiza e të ardhurave rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë patur burim financiar ligjor të mjaftueshëm për të krijuar këtë deponitë.

Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se për këtë aset:

✓ ***Përputhet deklarimi i bashkëshortes së subjektit me përgjigjen e bankës IntesaSanPaolo.***

✓ ***Burimi për krijimin e deponitës është i ligjshëm.***

6. Depozitë në Bankën Kombëtare Tregtare, me gjendje në datë 30.4.2018, në vlerën 2.400.000 lekë. Zotërimi 100%.

Burimi i të ardhurave, dhuruar nga prindërit (babai dhe nëna), në shumën 2.900.000 lekë.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë aset.

6.1 ILDKPKI, me shkresën nr.****prot, dt. 21.6.2019 ka sjell informacion se subjekti e ka deklaruar këtë aset në deklaratën e interesave private në vitin e krijimit (vitin 2017).

6.2 Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr.****/*prot, dt. 23.7.2019, konfirmon se M.Veliu disponon deponitë, me gjendje në dt. 30.4.2018, në vlerën 2.400.000 lekë.

6.3 Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr.****/*prot, dt. 23.7.2019, konfirmon kreditimet e shumave 1.450.000 lekë + 1.450.000 lekë, nga prindërit në llogarinë e znj. M.Veliu.

6.4 Komisioni hetoi në lidhje me faktin e dhurimit dhe mundësitë financiare të prindërve të bashkëshortes së subjektit, ku rezultoi e provuar me dokumentacin justifikues ligjor burimi i vlerës 2.900.000 lekë dhe kalimi i saj nëpërmjet sistemit bankar.

6.5 Gjatë procesit, subjekti është pyetur në lidhje me dhurimin në pyetësorin e dt. 10.7.2019, ku ka paraqitur dokumentacion justifikues si:

-Deklaratë noteriale nr.****rep, nr.****kol, dt. 3.5.2017, deklarues shtetasit me inicialet B.L dhe V.L të cilët me vullnetin e tyre kanë deklaruar se në dt. 31.3.2017 kanë nënshkruar aktin “Kontratë Shitblerje-Pasurie nr.***rep, nr. ***kol” e llojit apartament, me sip. 61 m2, ndodhur në Vlorë, shitur në vlerën 2.900.000 lekë. Shumë të cilën i’a dhurojnë vajzës së tyre 2.900.000 lekë, vlerë të cilën do të transferohej në bankën BKT.

-Kontratë Shitblerje nr.****rep, nr.****kol, dt. 31.3.2017, shitës shtetasit me inicialet B.L dhe V.L dhe blerës shtetasia me inicialet E.I, për apartamentin me sip. 61 m2, në vlerën 2.900.000 lekë.

-Certifikatë pronësie nr.***, dt. 25.4.2017, për apartamentin me sip. 61 m2, e regjistruar në emër të shtetasës E.I.

-Mandat BKT, dt. 3.5.2017, kalim i vlerës 1.450.000 lekë, nga B.L tek M.Veliu, me përshkrimin "Dhurim me deklaratë noteriale për M.Veliu nr.***rep, nr.***kol.

-Mandat BKT, dt. 3.5.2017, kalim i vlerës 1.450.000 lekë, nga V.L tek M.Veliu, me përshkrimin "Dhurim me deklaratë noteriale për M.Veliu nr.***rep, nr.***kol".

Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se:

- ✓ **Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Bankës Kombëtare Tregtare.**
- ✓ **Burimi financiar që kanë shërbyer për krijimit e këtij aseti, është i ligjshëm.**
- ✓ **Subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë kryer deklarim të rremë.**

7. Llogari page në Bankën Kombëtare Tregtare, me gjendje në datë 30.4.2018, në vlerën 90.000 lekë. Zotërimi 100%.

Burimi i të ardhurave nga paga.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë aset.

7.1 Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr.***prot, dt. 23.7.2019, konfirmon se M.Veliu disponon llogari page, me gjendje në dt. 30.4.2018, në vlerën 90.092 lekë.

7.2 Komisioni hetoi në lidhje me mundësitë financiare dhe nga analiza e të ardhurave rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë patur burim financiar ligjor të mjaftueshëm për të krijuar këtë llogari.

Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se:

- ✓ **Përputhet deklarimi i bashkëshortes së subjektit me përgjigjen e Bankës Kombëtare Tregtare.**
- ✓ **Burimi financiar për këtë llogari është i ligjshëm.**

DETYRIMET FINANCIARE NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

Detyrim aktual

8. Kredi bankare, e marrë në bankën Credins, në vlerën 5.000.000 lekë, me afat 10 vjet, me këst mujor në shumën 46.000 lekë. Kredia është marrë për pronotim apartamenti banimi. Shuma e detyrimit 4.848.751 lekë.

Subjekti vlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë Vetting të dorëzuar në datë 30.4.2018 edhe kontratën e kredisë nr.***rep, nr.***kol, dt. 13.7.2017.

Hetimi i kryer nga Komisioni në lidhje me këtë detyrim.

8.1 ILDKPKI, me shkresën nr.***prot, dt. 21.6.2019 ka sjell informacion se subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në deklaratën e interesave private 2017.

8.2 Credins Bank, me shkresën nr.***prot, dt. 22.8.2019, konfirmon se z. Ardi Veliu dhe znj. M.Veliu janë kredimarrës të shumës 5.000.000 lekë, në vitin 2017, me gjendje detyrimi në dt. 30.4.2018, në shumën 4.847.751 lekë.

8.3 Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, me shkresën nr.***prot, dt. 1.7.2019 konfirmon se nga regjistri elektronik i noterëve rezulton kryerja e kontratës së kredisë, nr.***rep, nr.***kol, dt. 13.7.2017.

Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se:

- ✓ **Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, me përgjigjen e Bankës Credins dhe regjistrin noterial.**

9. **Detyrim** ndaj shoqërisë “*****”shpk, për pronotim të apartamentit të banimit, me afate dhe këste sipas përcaktimeve të bëra në kontratën me nr.*****rep, nr.*****kol.

✓ **Trajtuar më gjerë në pikën 4.**

10. **Raportim** nga një institucion i specializuar, i cili ka dalë nga hetimi administrativ, konkretisht OSHEE, me shkresat nr.*****/*, dt. 15.7.2019 dhe nr.*****/* dt. 9.8.2019, konfirmon se subjekti Ardi Veliu është abonent me kontratë furnizimi energji elektrike, me nr.***, në instancën Vlorë, adresa “*.****”, Lgj. *.*****, Rr. “*****”, statusi kontratë aktive, kategoria familjar.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë raportim.

10.1 **Agjencia Shtetërore e Kadastrës Vlorë**, me shkresën nr.***prot, dt. 16.7.2019 konfirmon se subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë të regjistruar pasuri të paluajtshme në emrin e tyre në rrethin e Vlorës.

10.2 **Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë**, me shkresën nr.***prot, dt. 1.7.2019 konfirmon se nga regjistri elektronik i noterëve nuk rezulton të ketë një veprim noterial të subjektit Ardi Veliu në lidhje me apartamentin për të cilin ka lidhur kontratën me OSHEE.

10.3 **Gjatë procesit**, subjekti është pyetur në pyetësorin e dt. 29.8.2019 në lidhje me përgjigjen e OSHEE, ku ka dhënë sqarime se banesa për të cilën është lidhur kontrata e energjisë elektrike është në pronësinë e babait shtetasit Z.V. Kontrata është lidhur në emrin e subjektit pasi në atë kohë ka jetuar me ta.

10.4 **Dokumentacioni i paraqitur;**

-Certifikatë pronësie për pasurinë e llojit apartament, ndodhur në Vlorë, në emër të Z.V.

-Kontratë shitblerje nr.***rep, nr.***kol, dt. 31.7.2006, ku shtetasi Z.V ka blerë apartament, ndodhur në Vlorë, në shumën 3.700.000 lekë.

-Vërtetime mbi të ardhurat e babait të subjektit z. Z.V të cilat kanë shërbyer për krijimin e pasurisë.

-Vërtetim nr.***, dt. 27.8.2019 nga Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural Agjensia Rajonale e Shërbimit Veterinare dhe Mbrojtjes së Bimëve ku vërtetohet në bazë të të dhënave të arkivuara pranë zyrës Delvin, se fermeri Z.V ka qenë i regjistruar në fshatin Fushverri, njësia Vergo, Bashkia Delvinë me kod ferme AL***** dhe ka mbareshtuar në fermën e tij prej vitit 1993 deri në dt. 5.1.2011, bagëti të imta ***krerë (aset biologjik). Kjo fermë prej kësaj date i ka kaluar në emër të fermeres H. V dhe ka kryer matricullime deri në vitin 2015 për ***krerë, bagëti të imta.

-Vërtetim nr.***, dt. 27.8.2019 nga Bashkia Delvinë Njësia Administrative Vergo, ku vërtetohet se i ndjeri Z.V, banor i fshatit Fush-Vërri, njësia administrative Vergo ka qenë fermer me blektori të imët (dele) nga viti 1992 deri sa ndërroi jetë me datë 5.1.2013.

Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se:

✓ **Pasuria e paluajtshme është blerë dhe hipotekuar në emër të shtetasit Z.V (babai subjektit).**

✓ **Subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat e babait, burim i cili ka shërbyer për blerjen e apartamentit.**

✓ **Deklarimi i subjektit konfirmohet nga institucionet e specializuara, dokumentacioni i paraqitur dhe sqarimet e dhëna.**

PËRFUNDIME PËR PROCESIN E VLERËSIMIT TË PASURISË

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, u bë analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se;

Subjekti dhe bashkëshortja e tij deri në momentin e dorëzimit të deklaratës datë 30.4.2018 zotërojnë asete/likujditete/detyrime si më poshtë:

Asete/detyrime/ likujditete	Vlera
Depozitë bankare në BKT, në emër të Ardi Veliu, në vlerën 735.569 lekë.	Vlera 735.569 lekë.
Depozitë bankare në “Credins”, në emër të Ardi Veliu, në vlerën 5.000 euro.	Vlera 5000 euro, e konvertuar në valutë vendi 643.700 lekë.
Llogari bankare në “Credins”, në emër të Ardi Veliu, në vlerën 201.921 lekë.	Vlera 201.921 lekë.
Pronotim apartament, më dt. 23.11.2017, sip. Ap 141.8m2, sip. verande 55m2 si dhe pjesa e përbashkët me sip. 23.6 m2, adresa Komuna Farkë, Tiranë, në vlerën 79.703 euro.	Vlera 79.703 euro, e konvertuar me valutë vendi 10.260.964 lekë.
Llogari bankare në IntesaSanPaolo, në emër të M.Veliu, në vlerën 800.000 lekë.	Vlera 800.000 lekë.
Llogari bankare në BKT, në emër të M.Veliu, në vlerën 2.400.000 lekë.	Vlera 2.400.000 lekë.
Llogari bankare në BKT, në emër të M.Veliu, në vlerën 90.092 lekë.	Vlera 90.092 lekë.
Detyrim kredie në Bankën “Credins”, në shumën 4.848.751 lekë.	Shuma 4.848.751 lekë.
Detyrim ndaj shoqërisë së ndërtimit, në shumën 34.166 euro.	Shuma 34.166 euro, e konvertuar në valutë vendi, 4.398.530 lekë.

- **Vlera e pasurisë së krijuar deri në datë 30.4.2018 sa më sipër**, është në vlerën bruto **15.132.246 lekë** dhe në vlerën neto **5.884.965 lekë**.
- **Vlera e detyrimeve financiare** është në shumën totale **9.247.281 lekë**, (kredi në Bankën Credins dhe detyrim ndaj shoqërisë “*****”shpk)
(përdorur kursi i datës 30.4.2018 sipas Bankës së Shqipërisë, 128.74 euro)

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

Të ardhurat nga pagat subjekti Ardi Veliu (lekë) Sipas dokumentacionit ligjor të paraqitur dhe institucioneve	Të ardhurat nga pagat e znj. M.Veliu (lekë) Sipas dokumentacionit ligjor të paraqitur dhe institucioneve
13.030.000 lekë	11.977.000 lekë
Në total të ardhura sa më sipër = 25.007.000 lekë	
Shpenzimet INSTAT periudha 1998 - 2018 = 10.570.000 lekë	

Gjithashtu si burim në krijimin e aseteve kanë shërbyer:

Kredi në Credins Bank në shumën 5.000.000 lekë.
Detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit “*****”shpk.

Subjekti dhe bashkëshortja kanë deklaruar shpenzime:

Shpenzime për qera banese për vitin 2017	në shumën 240.000 lekë
Shpenzime për udhëtime familjare për vitet 2015 - 2017	në shumën 150.000 lekë
Në total	në shumën 390.000 lekë.

Nga analiza financiare në vite të deklarimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve, rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë patur burim të ardhurash ligjor të mjaftueshëm për përballimin e shpenzimeve të kryera për secilin vit respektiv.

Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror në përputhje me pikën 6, të nenit 34 të Ligjit nr. 12/2018, konstaton se:

- a) *deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë në përputhje me Ligjin,*
- b) *ka burime financiare të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë,*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë,*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë,*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

V – B. KONTROLLI I FIGURËS:

1. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të vlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimin e atyre që janë përfshirë apo kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë veprimtari kriminale.
2. Subjekti Ardi Veliu në zbatim të nenit 36, pika 2 e ligjit nr. 12/2018 “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*”, ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në datën 30.4.2018, brenda afatit ligjor.
3. Kontrolli i figurës për subjektin e vlerësimit Ardi Veliu, është kryer bazuar në përcaktimet e nenit 4, pika 1, gërma b dhe neneve 35-42, 48 dhe 51 e 52 të parashikuara në ligjin nr.12/2018 “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*” i ndryshuar.
4. Procedura për kontrollin e figurës është kryer sipas përcaktimeve të nenit 36-37 për bashkëpunimin me institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, informuese dhe verifikuese në vend dhe jashtë tij, verifikimit të informacioneve nga publiku në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo personave të lidhur, si dhe vlerësimit të provave, informacioneve

të klasifikuara dhe informacioneve të tjera të disponueshme që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, përfshirë rrethanat rënduese dhe lehtësuese bazuar në ato që parashikohen në nenin 38-41 të ligjit.

5. Trupa vlerësimit ka proceduar në dy momente të rëndësishme të verifikimit të figurës sipas ligjit 12/2018:
 1. *Fillimisht është administruar dhe verifikuar Formulari i Kontrollit të Figurës i plotësuar nga subjekti si detyrim i ligjit 12/2018.*
 2. *Dhe më tej janë administruar përgjigjet nga institucionet ligjzbatuese, verifikuese dhe informuese.*
6. Për të kontrolluar figurën dhe saktësinë e deklaramit për subjektin e vlerësimit, janë kryer veprime hetimore duke kërkuar të dhëna me anë të korrespondencës zyrtare pranë institucioneve si më poshtë të cilat konfirmojnë:
7. ***Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar***, me shkresën nr.****prot, datë 4.7.2019 konfirmon se subjekti Ardi Veliu është pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), niveli Tepër Sekret, e vlefshme nga data 7.2.2018 deri në 13.11.2022.

Në vazhdim të bashkëpunimit, DSIK, me shkresën nr.****prot, datë 29.10.2019 konfirmon se nga periudha e lëshimit të CSP e deri tani, në DSIK nuk është adresuar asnjë informacion implikues për z. Ardi Veliu, nga autoritetet Verifikuese apo Institucione ligjzbatuese, sipas të cilit do të ishte e nevojshme rishikimi i vendimit të marrë për lëshimin e CSP.
8. ***Institucioni ligjzbatues***, me shkresën nr.****prot, datë 5.8.2019, konfirmon se pas verifikimeve të kryera për z. Ardi Veliu dhe lidhjes së tij familjare nuk disponon të dhëna.
9. ***Institucioni ligjzbatues***, me shkresën nr.****prot, datë 1.7.2019 konfirmon se pas verifikimeve të kryera për z. Ardi Veliu dhe lidhjes së tij familjare nuk disponon të dhëna, materiale referuese/procedime penale në ngarkim të tyre.

Në vijim të bashkëpunimit, ***Institucioni ligjzbatues***, në zbatim të ligjit 12/2018, ka përcjell materiale shtesë për subjektin Ardi Veliu, me shkresat nr.***prot, datë 1.10.2019, datë 16.10.2019 dhe datë 21.10.2019. Këto materiale, pavarësisht se kanë kaluar të gjitha afatet e normuara në kuadër ligjor të kohës mbi veprimtarinë operative gjurmuese, në respekt të trasparencës dhe në përputhje me nenin 35 e në vijim të ligjit 12/2018, na bëjnë me dije se, në ngarkim të subjekti Ardi Veliu, në periudhën 2002 – 2003 por edhe në vitin 2007, periudhë e cila subjekti i vlerësimit ka qenë oficer, me detyrë Shef Sektori të Uniformave, në Drejtorinë e Policisë Qarkut Vlorë dhe Shef i Uniformave në Drejtorinë e Policisë Qarkut Vlorë, për të cilin ka raportime se gjatë kësaj periudhe ka qenë i implikuar në veprimtari të paligjshme, në përmbushje me detyrën dhe pengmin e saj, ka qenë i implikuar në favorizimin e lëvizjes klandestine, në favorizimin e kontrabandës së naftës dhe favorizimin e një punonjësi të Policisë së Qarkut Vlorë për kryerjen e pasaportave fallco.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me raportimet.

- 9.1** Komisioni ka kryer një hetim të thellë për subjektin e vlerësimit, duke marrë shkas nga raportimet e referuar më sipër dhe ka kërkuar informacion nga institucionet ligjzbatuese për të verifikuar çdo pretendim të parashtruar.
- 9.2** Bazuar në përmbajtjen e raporteve të Institucionit Ligjzbatues, i njëjti Institucion Ligjzbatues, në kohë dhe në shkresë të ndryshme, ndonëse në hark të shkurtër kohor, mban qëndrime dhe kryen raporte kontradiktore për të njëjtin subjekt vlerësimi, lidhur me të njëjtin shkak dhe për të njëjtat rrethana referuese.
- 9.3** Vijueshmëria e raporteve të ndryshme nuk rezulton në asnjë rrethanë të jetë e shoqëruar me fakte, prova, evidence, dëshmi, verifikime, të ndryshueshme në kohë apo të reja, në eventualitet apo të azhornuara si të tilla së fundmi. Bazuar në vetë përmbajtjen e këtyre raporteve rezulton se nuk ka pasur veprime të mëtjshme dhe të vijuara, dhe për më tepër nuk rezulton që veprimtari të tilla, të pretenduara si të kundraligjshme apo me natyrë kriminale të jenë procedur komform ligjit si dhe të jenë referuar në organin e prokurorisë.
- 9.4** Komisioni i ka dërguar shkresë për informacin, me nr.***prot, datë 24.12.2019, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ku i ka kërkuar të verifikoj subjektin e vlerësimit z. Ardi Veliu nëse ai ka pasur procedime penale të filluara, pushuara, pezulluara ose të dërguara për gjykim nga periudha 1998 deri në marrjen e kësaj kërkesë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me shkresën nr.***prot, dt. 6.1.2020 informon se nga verifikimet e kryera në regjistrin e veprave penale në të cilin pasqyrohen hedhje e të dhënave për personat ndaj të cilëve është regjistruar procedim penal nuk figuron të ketë procedim në ngarkim të këtij shtetasi.
- 9.5** Gjithashtu marrë në harmoni të gjitha korespondencat zyrtare me intitucionet ligjzbatuese si Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroritë e Rretheve, Prokuroria e Krimive të Rënda, DSIK, SHISH, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Avokati i Popullit, nuk rezulton të ketë asnjë të dhënë qoftë edhe dyshuese për veprimtari të kundra ligjshme në të cilat të jetë përfshirë subjekti i vlerësimit Ardi Veliu, në shqyrtim administrativ.
- 9.6** Gjatë seancës dëgjimore publike, të zhvilluar në datë 6.2.2020, subjektit të vlerësimit, ju dha fjala për të shpjeguar dhe deklaruar nëse kishte diçka në lidhje me raportin e relatuar nga relatori i çështjes, ai deklaroi në lidhje me raportimet e ardhura nga intitucioni ligjzbatues se janë të pa vërteta dhe përjashtoj çdo lloj mundësie se ai mund të jetë marrë apo përfshirë në veprimtari të kundraligjshme, gjithashtu theksoi se në datën 11.8.2006, është larguar nga Policia e Shtetit me kërkesën e tij, kështu që edhe raporti se ai në vitin 2007 ka kryer veprime të kundraligjshme si punonjës i Policisë së Qarkut Vlorë bien poshtë.
- 9.7** Nga verifikimi idosjes së personelit ardhur nëpërmjet shkresës nr.***prot, datë 18.9.2019, në kartelën e punës konfirmohet se subjekti i vlerësimit në datë 11.8.2006 është larguar nga policia e shtetit me kërkesën e tij.

Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se:

- ✓ **Për sa më sipër, raportimet nga Intitucioni Ligjzbatues, nuk mund të ndikojnë dhe të merren në konsideratë në vlerësimin e këtij shqyrtimi administrativ, lidhur me subjektin e vlerësimit Ardi Veliu, si të bazuar në prova dhe ligj.**

10. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti i Policisë Kriminale, me shkresën nr.*** prot, datë 28.6.2019, konfirmon se pas verifikimeve të kryera në Sektorin e

Kartotekës, në Drejtorinë e Analizës dhe Informacionit, rezulton se shtetasi Ardi Z Veliu dhe personat e lidhur me të, nuk janë të regjistruar për veprimtari kriminale.

11. Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit me shkresën nr.**** prot, datë 24.07.2019, Informon KJV - në, për vendimin nr.****, datë 18.7.2019 e marrë nga AIDSSH për subjektin e vlerësimit Ardi Veliu.

11.1 Në këtë vendim AIDSSH ka vendosur:- *Të informojë Institucionin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, se nga verifikimet e kryera deri tani për shtetasin Ardi Z eliu nuk rezulton të ketë qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, të ketë qenë anëtar, bashkëpunor ose i favorizuar nga ish – Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991, në zbatim të ligjit 12/2018, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Doklumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë”.*

12. Drejtoria e Përgjithshme Policisë së Shtetit, me shkresën nr.****prot, datë 14.8.2019 nëpërmjet verifikimeve në TIMS na konfirmon të gjitha hyrjet-daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë për periudhën 1.1.2016-13.8.2019 për subjektin dhe personat e lidhur me të.

KJV komunikoi me shkresë me DPSHTRR për verifikimin e targave të konfirmuara nga TIMS.

13. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria e Regjistrimit të mjeteve, me shkresën nr.****prot, datë 7.10.2019 me kërkesën e KJV ka verifikuar të gjitha targat e konfirmuara nga sistemi TIMS për të gjitha hyrjet-daljet nga Territori i Republikës së Shqipërisë.

✓ *Nga verifikimi i targave dhe personave përgjegjës të këtyre automjeteve rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë udhëtuar apo kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në veprimtari kriminale.*

14. Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria Gjyqësore, me shkresën nr.***prot, datë 20.9.2019 konfirmon se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është përcjellë materiali: “Vendim për mosfillimin e procedimit penal nr.***prot ndaj shtetasve me inicialet A.Ç dhe R.J dhe subjektit të vlerësimit z. Ardi Veliu”, gjithashtu ajo raporton se Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë; Kukës, Dibër, Elbasan, Shkodër, Pukë, Përmet, Kurbin, Gjirokatër, Kavajë, Durrës, Korçë, Tropojë, Mat, Lezhë, Berat, Krujë, Vlorë, Pogradec, Lushnje, Sarandë dhe Fier, konfirmojnë se për shtetasin Ardi Veliu, nuk është nxjerr urdhër ndalimi, nuk ka kërkuar masa për sigurim personal, nuk është marrë në cilësi e të pandehurit apo personit nën hetim, nuk ka pasur regjistrim të veprave penale dhe nuk ka urdhër ndërkombëtar të ndalimi.

15. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me shkresën nr.***prot, datë 1.8.2019 konfirmon se ndaj shtetasit Ardi Veliu, nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.

16. Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Departamenti për Shërbimet Mbështetëse, me shkresën nr.****prot, datë 17.10.2019, ka përcjellë formularin e vetdeklarimit bazuar në

kërkesën e KJV për vënie në dispozicion të formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 i ndryshuar dhe Vendimit të Kuvendit 17/2016 të dalë në zbatim të tij për subjektin Ardi Veliu.

16.1 Komisioni fillimisht kreu verifikimin formal të këtij formulari, duke krahasur atë edhe me vërtetësinë e të dhënave të plotësuar në formularin e kontrollit të figurës si dhe më tej në zbatim të përcaktimeve të ligjit specifik 138/2015.

16.2 Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka raportuar ndonjë të dhënë për të cilën duhej të fillonte verifikimi i thelluar sipas kritereve dhe kushteve të ligjit 138/2015.

16.3 Veprimet e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit janë kryer në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme dhe orientimeve të saj.

✓ *Për sa më sipër, rezulton se deri më tani nuk ka rrethana, ngjarje apo të dhëna/indicje për të cilat të diponohen infomacione në ngarkim të subjektit, për të cilin duhen nisur hetime të thelluara nga organet ligjzbatuese.*

17. Avokati i Popullit, me shkresën nr.****prot, datë 7.8.2019, nuk konfirmon të ketë pasur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht për subjektin Ardi Veliu.

18. Drejtoria Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet postës elektronike, në datë 10.7.2019 ka konfirmuar se subjekti Ardi Veliu rezulton i padënuar.

19. Pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, janë paraqitur 2 (dy) denoncime :

19.1 Ankim i depozituar pranë KJV-së, dt. 15.10.2019, nga shtetasi S.R, me objekt “Ankim, njëkohësisht edhe ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit z. Ardi Veliu, për qëndrime të paligjshme në detyrë”.

19.2 Ankim i depozituar pranë KJV-së, dt. 25.11.2019, nga Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit, me objekt “Dërgim material mbi shkeljet ligjore të z. Ardi Veliu, në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit”.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me denoncimet.

19.3 Komisioni ka kryer një hetim të thellë për subjektin e vlerësimit, duke marrë shkas nga indiciet e denoncimeve, referuar sa më sipër dhe ka kërkuar informacion nga institucionet ligjzbatuese për të verifikuar çdo pretendim të parashtruar.

19.4 Në kuadër të verifikimit të pretendimeve të parashtruara në denoncim, Komisioni ka kryer hetim dhe ka mbledhur informacion për subjektin nga institucionet: DSIK, SHÇBA, SHISH, Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Krimeve të Rënda, Prokurorinë e Rrethit Tiranë, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Avokatin e Popullit.

19.5 Subjekti i vlerësimit z. Ardi Veliu, në lidhje me denoncimet e drejtuara ndaj tij, i njohur me to nga relacionin paraprak, ka paraqitur pranë KJV sqarime lidhur me denoncimet, duke deklaruar se:

a) Në lidhje me ankimin e depozituar pranë KJV-së, datë 15.10.2019, nga shtetasi S.R, me objekt: “Ankim njëkohësisht edhe ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit z. Ardi Veliu, për qëndrim të paligjshëm në detyrë”.

Duke u bazuar në korrespondencat dhe përgjigjet e shumta që ka patur me strukturat e varësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, gjykojë se ankimi i shtetasit me

inicialet S.R, lidhet me zotit S.R, aktualisht me detyrë shef sektori, në sektorin për kufirin dhe migracionin, në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit Gjirokastër. Përsa i përket pretendimeve të këtij shtetasi (aktualisht punonjës policie), më lejoni t'Ju sqarojë se: Referuar urdhërit të ekzekutimit nr.**** akti, datë 29.07.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe Vendimit nr.72, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese, strukturat e Burimeve Njerëzore në Policinë e Shtetit, mbi bazën e shënimeve të mija shkresore si Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, kanë ndjekur procedurën për rikthimin në Policinë e Shtetit të z. S.R. Fillimisht është bërë njoftimi i tij, nëpërmjet shkresës nr. 980/1 datë 15.11.2017, referuar nenit 183 të Rregullores së Policisë së Shtetit dhe më pas është komunikuar verbalisht nga Shefi i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për fillimin e procedurave dhe plotësimin e dokumenteve nga ana e tij. Gjatë këtij procesi, zotit S.R dhe përmbauesit gjyqësor privat z. A.R, u është bërë e ditur se në bazë të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe vendimit nr.892 datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit”, i takon të rikthehet në Polici me gradën “Kryekomisar”, gradë kjo e njohur me vendimin e mësipër të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë. Theksojë se në këtë proces, z. S.R ka pretenduar për ti dhënë gradën “Drejtues i Parë”. Nga ana e Drejtorisë Juridike dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, z. S.R është sqaruar se, referuar dispozitave të ligjit nr.108/2014, i ndryshuar si dhe vendimit nr.892 datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit”, *nuk parashikohet ekuivalentim i gradave policore*, të marra përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. Mbi këtë bazë, nga ana ime, me autoritetin e titullarit të institucionit të Policisë së Shtetit, është miratuar urdhëri nr.***, datë 02.03.2018, për rikthimin në Policinë e Shtetit të z. S.R, duke i dhënë gradën “Kryekomisar” dhe emëruar në detyrë, Shef Sektori, në Sektorin e Trajnimeve dhe Mjeteve Motorike, në Drejtorinë e Çertifikimeve dhe Shërbimeve ndaj të Tretëve, në Akademinë e Sigurisë, me të drejta financiare nga data 06.03.2018. Më pas, për nevoja pune, ai është transferuar me detyrë shef sektori, në sektorin për kufirin dhe migracionin, në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit Gjirokastër. Këtë detyrë z. S.R e ka pranuar me vullnet të plotë, duke përfituar edhe pagën e plotë, me të gjithë elementët e saj për këtë gradë, nga muaj mars i vitit 2018 e në vazhdim. Përsa më sipër, Ju konfirmojë se, nuk kam treguar qëndrim të paligjshëm në detyrë ndaj këtij shtetasi, por, përkundrazi, kam respektuar me korrektesë vendimin gjyqësor, në pajtim të plotë me ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar si dhe vendimin nr.892 datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit”.

- b) Në lidhje me ankimin e depozituar pranë KJV-së, datë 25.11.2019, nga Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit, me objekt: “Dërgim materiali mbi shkeljet ligjore të zotit Ardi Veliu, në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit”.

Problematika ndërmjet Sindikatës së Punonjësve të Policisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku sindikata ka pretenduar se i janë shkelur të drejtat, duke mos u zbatuar në vazhdim kontrata kolektive nr.1966Prot., datë 03.04.2009, nuk qëndron për arsye se: Kontrata e lidhur në vitin 2009, ndërmjet drejtuesit të Policisë së Shtetit dhe

Sindikatës së Policisë, i referohej ligjit të mëparshëm të Policisë, atij nr. 9749 dt.04.06.2007, ligj i cili është i shfuqizuar. Në këtë ligj përcaktohej që, Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit ishte një dhe e vetme, ndërkohë që sot në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, konkretisht në nenin 83, të tij është përcaktuar që:“...*Në polici lejohen krijimi dhe zhvillimi i veprimeve sindikaliste në përputhje me legjislacionin në fuqi.... marrëdhëniet ndërmjet sindikatave dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, rregullohen në kontratën kolektive..*”. Është e rëndësishme të citojë nenin 2 të kontratës kolektive nr.1966 Prot., datë 03.04.2009, ku gjendet e shprehur se: “*Kontrata lidhet për një afat të pacaktuar. Zgjidhja e kësaj kontrate mund të bëhet nga secila palë kur paraqiten shkaqe të arsyetuara dhe mbasi palët janë njoftuar jo më pak se 6 (gjashtë) muaj më parë*”. *Kur paraqiten rrethana të reja që nuk mund të parashikoheshin apo janë parashikuar... ..., palët kontraktuese mund të ndër marrin edhe bisedime dhe me mirëkuptim bëjnë ndryshimet përkatëse*”. Ndryshimet në ligjin e Policisë së Shtetit, diktojnë detyrimisht ndryshime dhe përcaktime të reja edhe në kontratën kolektive. Nisur nga këto ndryshime ligjore, ka pasur shkëmbim korrespondence ndërmjet Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku sindikata nga ana e saj, ka paraqitur draftkontratën kolektive për nëshkrim. Për shkak të funksionit që kryej dhe detyrimit që më ngarkon ligji, qëllimi im, është mbrojtja e interesave dhe të drejtave të të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit, në shkallë vendi. Për këtë arsye, nga ana ime, draftkontrata e përcjellë nga sindikata, i është dërguar asaj sugjerimet konkrete. Por, deri tani, ajo, nuk ka dakordësuar. Një prej kërkesave kryesore të kësaj sindikate është mbledhja në formë “*të detyruar*” nga institucioni, të kuotizacionit (pagesës së tarifave për anëtarësim), *ku kërkohet t`u mbahet punonjësve të policisë së shtetit nga paga e tyre*. Aktet ligjore në fuqi në vendin tonë, në asnjë dispozitë nuk kanë të përcaktuar mbajtjen apo ndalesën me detyrim të pagës, për të paguar sindikatën. Duke qenë se nuk ndodhemi përpara një akti detyrues për mbajtjen nga paga të këtij kuotizacioni, kemi sugjeruar heqjen dorë nga kjo kërkesë/pikë e parashikuar në draftkontratën e përcjellë, **pasi pjesmarrja në sindikatë është e lirë dhe shpreh vullnetin e secilit punonjës** dhe se vetë sindikata duhet të gjejë mjetet ligjore për të mbledhur këto tarifa apo kuotizacione, mbi baza vullnetare. Përsa sipër, Ju konfirmoj se, nuk kam shkelur asnjë dispozitë të ligjit në marrëdhënie me Sindikatën e Policisë. Përkundrazi, gjithnjë kam shprehur vullnetin tim pozitiv për zgjidhjen e këtij problemi, njëkohësisht kam mbrojtur dhe do të vazhdojë të mbrojë interesat e punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët janë të lirë të zgjedhin sindikatën e tyre.

Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se:

- ✓ *Pas një hetimi të thelluar për pastërtinë e figurës së subjektit, nga institucionet ligjzbatuese nuk u konfirmua asnjë pretendim i parashtruar në denoncime, që të përbënte shkak për cenimin e figurës së subjektit të vlerësimit.*

20. Bazuar në ligjin 12/2018, neni 38, pika 2, subjekti i është nënshtruar një **Vlerësimi Psikologjik**. Në datë 23.12.2019 ka ardhur raporti i vlerësimit psikologjik ku në bazë të rezultateve ka rezultuar se subjekti i vlerësimit Ardi Veliu:

- aktualisht nuk paraqet probleme të shëndetit mendor ndaj është mendërisht i aftë të funksionoj në aspektin okupacional, ndërpersonal, social dhe familjar;

- paraqet marrëdhënie të stabilizuara personale dhe ndërpersonale;
- subjekti nuk paraqet problematika të personalitet, që mund të çënojnë realizimin e detyrave dhe aktivitetin e tij në tërësi si dhe shfaq shkallë të lartë të funksionimit në plotësimin e këtij aktiviteti.

20.1 *Ky raport është vlerësuar nga dy ekspertë pjesëmarrës nga Këshilli i Psikologut, Dr. V.T dhe Msc. B.T.*

Në përfundim të hetimit të kryer:

Komisioni pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Ardi Veliu, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, analizimin dhe verifikimin e të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, si dhe vlerësimit psikologjik, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit Ardi Zenel Veliu;

- a) ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*
- b) nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në veprimtari kriminale;*
- c) punonjësi është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.*

VI – C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE:

1. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit.
2. Subjekti Ardi Veliu në zbatim të nenit 44, pika 1 e ligjit nr. 12/2018 “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*”, ka dorëzuar formularin e vetëvlerësimit të aftësive profesionale, në datën 30.4.2018 brenda afatit ligjor.

Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në tre elemente:

- 1. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018;*
- 2. të dhënat e mbledhura nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 3, e ligjit 12/2018;*

3. tre dokumente të depozituara nga subjekti i vlerësimit, në zbatim të nenit 46, pika 3, dhe nenit 44, pika 2, të ligjit 12/2018, i ndryshuar, të cilët janë përgatitur në ushtrim të detyrave funksionale të subjektit të vlerësimit si punonjës në Policinë e Shteti.

3. Subjekti i vlerësimit Ardi Veliu në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018 ka ushtruar funksionin e “Drejtorit të Përgjithshëm në Policinë e Shtetit, funksion të cilin e ushtron edhe aktualisht.

Në lidhje me Vlerësimin e nivelit të arsimimi të subjektit të vlerësimit rezulton se:

4. Subjekti i vlerësimit është diplomuar:

Data e fillimit	Data e përfundimit	Emri i plotë i institucionit ku keni ndjekur studimet	Titulli i fituar apo teza e mbrojtur	Adresa e institucionit	Vendi/Shteti
9/1987	6/1991	Shkolla e Mesme Ushtarake “Skënderbej”-Tiranë.	Dëftesë Pjekurie	Tiranë	Shqipëri
9/1991	7/1993	Akademia Ushtarake “Skënderbej”.		Tiranë	Shqipëria
9/1993	12/1993	Akademia e Policisë	Ndërprerje për të vazhduar studimet në Itali.	Tiranë	Shqipëri
1/1994	6/1998	Akademia e Policisë	Diplomua	Ankara	Ankara-Turqi
1.9.2003	30.6.2007	Universiteti “Ismail Qemali”-Vlorë	Diplomuar - Ekonomist	Vlorë	Vlorë Shqipëri
1.9.2008	11.7.2001	Universiteti “Justicia” Tiranë	Diplomuar - Jurist	Tiranë	Tiranë Shqipëri

Komisioni Komisioni Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se në kuptim të ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, nenit 124, pika 2, e ligjit nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i vlerësimit:

✓ ***Përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që ushtron dhe gradën policore që mban si punonjës i Policisë së Shtetit.***

5. Në nenin 44, pika 2 dhe 3 e ligjit 12/2018, përcaktohet se: “*Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 7 (shtatë) vjet*”.
6. Në 7 (shtatë) vitet e fundit subjekti i vlerësimit Ardi Veliu ka punuar në funksionet si më poshtë:

Data e fillimit	Data e përfundimit	Institucion i	Funksioni	Emri dhe mbiemri i punëdhënësit apo eprorit të drejtëpërdrejtë:	Adresa e plotë e institucionit:	Arsyeja e largimit:
5.2.2018	Aktualisht	Policia e Shtetit	Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit	Këshilli i Ministrave	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	
1.6.2018	4.2.2018	Policia e Shtetit	Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Vendore të Policisë Tiranë	Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit	Rr. "S.Frashëri", Tiranë	Transferim
29.7.2016	27.4.2017	Policia e Shtetit	Drejtor i Policisë Rrugore Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.	Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	Transferim
15.6.2015	28.7.2016	Policia e Shtetit	Drejtor i Shkollës Bazë të Policisë	Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Shtetit	Akademia e Sigurisë Saut-Tiranë	Transferim
25.8.2014	14.6.2015	Policia e Shtetit	Zv/Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë	Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit	Rr. "S.Frashëri", Tiranë	Transferim
1.11.2013	24.8.2014	Policia e Shtetit	Shefi i Komsariatit Policisë, Drejtoria Vendore Durrës	Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit	Drejtoria Vendore Durrës	Transferim

Procesi i fitimi të gradës

Neni 45, pika 3, shkronja (c), e ligjit 12/2018, përcakton se: objekt i vlerësimit të afësive profesionale janë edhe ecuria në karrierë dhe procesi i fitimit të gradës, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Fitimi i gradës "N/Toger"

Nga aktet e administruara kontatohet se:

- Me urdhër nr. ****prot, datë 1.9.1998, "Për titullimin oficer dhe emërimin në detyrë të studentëve të akademisë së Rendit publik dhe atyre që mbaruan studimet në Akademinë e Policisë në Ankara" në bazë të nenit 32 të ligjit nr.7978, dt. 26.7.1995 "Për forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" urdhërohet ti jepet grada N/Toger studentit të diplomuar në Akademinë e Policisë në Ankara Ardi Veliu, i cili merr detyrën e Komandantit të Postës së Policisë së Rendit në Komisariatit e Policisë Tepelenë, urdhëruar nga Ministri i Brendshëm.

8. Fitimi i gradës "Kapiten"

Nga aktet e administruara kontatohet se:

- Me urdhër nr.****prot, datë 26.7.1999, "Për transferim dhe emërim në detyrë të një oficeri" në bazë të nenit 32, të ligjit 7978, datë 26.7.1995 "Për forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", nenit 43 të Ligjit nr. 7504, datë 30.7.1991 "Për Policinë e Rendit" urdhërohet se N/Toger Ardi Veliu me detyrë Komandant i Postës së Policisë së Rendit Memaliaj në Komisariatit Tepelenë, "për ngritje në përgjegjësi" të transferohet dhe të emërohet Shef i Sektorit të Policisë Rendit në Komisariatit e Policisë Vlorë, në Drejtorinë e Policisë Vlorë, ti jepet grada Kapiten, urdhëruar nga Ministri i Brendshëm.

9. Fitimi i gradës “K/Inspektor”

Nga aktet e administruara kontatohet se:

- Me urdhër nr.****prot, dt. 1.5.2003, “Për Inkuadrimin të Gradës Ushtarake në Gradën Policore” në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 22 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” të neneve 7,14,26 të ligjit nr. 8643, dt. 20.7.2000 “Për Gradat në Policinë e Shtetit” në pikat 1, 2, 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, dt. 2.2.2002 “Për inkuadrimin e Gradave Ushtarake, në Gradat e Policisë së Shtetit dhe për përcaktimin e funksioneve që do të ushtrohen sipas tyre dhe me propozim të Komisionit të Gradimeve për rolin e mesëm e të lartë sipas Vendimit nr. *, dt. 23.4.2003, urdhërohet që Kapiten Ardi Veliu, me detyrë Shef i Sektorit Shërbimeve të Përgjithshme të Policisë, në Drejtorinë e Policisë qarkut Vlorë ti jepet grada “Kryeinspektor”, urdhëruar nga Ministri i Brendshëm.

10. Fitimi i gradës “Komisar”

Nga aktet e administruara kontatohet se:

- Me urdhër nr.****prot, dt. 30.10.2013 “Për ripranim në strukturat e Policisë së Shtetit dhe caktimin në detyrë të z. Ardi Veliu”, bazuar në nenin 58 të ligjit nr. 9749, dt. 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, në nenin 62, pika 2, shkronja “b” të Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit si dhe Vendimin e Komisionit të Verifikimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë me “Urdhër nr.*****prot, dt. 30.10.2013 për ripranim në Polici, bazuar në nenin 58 të ligjit nr. 9747, dt. 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të pikës 3 dhe 4 të nenit 23 dhe nenit 45 të rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit, të ripranohet z. Ardi Veliu në strukturat e policisë, urdhërohet që z. Ardi Veliu ish punonjës policie, i liruar në vitin 2006 me motivacionin “Me kërkesë të tij” të ripranohet në strukturat e Policisë dhe të caktohet në detyrën, Shef Komisariati, në Komisaratin e Policisë Durrës, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, ti jepet grada policore “Komisar”, udhëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

11. Fitimi i gradës “Kryekomisar”

Nga aktet e administruara kontatohet se:

- Me urdhër nr.****prot, dt. 2.6.2014 “Për Dhënie e gradës policore të një punonjësi policie”, bazuar në nenin 20, pika 2, nenin 58, pika 2 të ligjit nr. 9749, dt. 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, në Procedurën Standarte “Ricertifikimi i punonjësve që ripranohen në polici”, miratuar me urdhër nr.*prot, dt. 9.5.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, në vendimin nr. *, datë 29.5.2014 Vendim nr. *, dt. 29.5.2014, “Për ricertifikim për gradën policore “Kryekomisar” të punonjësve të ripranuar në polici, mbështetur në nenin 58, pika 2, të ligjit nr. 9749, dt. 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, nenin 44 të Rregullores së Personelit, procedurën strandarte të ricertifikimit të miratuar me urdhën të Drejtorit të Përgjithshëm nr.***prot, dt. 9.5.2014 si dhe urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.***prot, dt. 12.5.2014 për “Krijimin e Komisionit të Ricertifikimit”, kumisioni i përbërë nga Drejtues A.S (Kryesues), Drejtues L.P (Anëtar) dhe Drejtues S.D (Anëtar), vendosi ti paraqes Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit vendimin për ricertifikim për gradën kryekomisar të punonjësve të ripranuar në polici, urdhërohet që Komisar Ardi Veliu, me

detyrë Shef Komisarati në Komisaratin e Policisë Durrës, në Qarkun Durrës, ricertifikohet për gradën “Kryekomisar”, ti jep grada “Kryekomisar”, udhëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

12. Fitimi i gradës “Drejtues”

Nga aktet e administruara kontatohet se:

- Me urdhrin, nr.****prot, datë 22.10.2014, “Për ngritje në gradë të një punonjësi Policie”, bazuar në nenin 42, pika 1, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 9749, dt. 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, nenin 50 pika 3 shkronja “a”, “Të rregullores së personelit të Policisë së Shtetit”, në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.***prot, dt. 1.10.2014 “Për miratimin e listës emërore të së drejtës për ngritje në gradën Drejtues”, si dhe urdhrin nr. ****prot, dt. 23.1.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë “Për ekuivalentimin e klurseve të trajnimit të zhvilluara nga Misioni Pameca Tiranë”, të ndryshuar me urdhër nr.****prot, dt. 30.8.2012, urdhërohet që Kryekomisar Ardi Velu, me detyrë zëvendësdrejtues për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Policisë Qarkut Tiranë, shpallur fitues në konkurimin për ngritje në gradën “Drejtues”, përfunduar kursin e barazvlefshëm /ekuivalent me shkollimin për nivelin e mesëm drejtues, i jepet grada policore “Drejtues”, udhëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
- Dëshmi dt. 12.11.2004, nga Ministria e Rendit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Akademia e Policisë “Arben Zylyftari”, z. Ardi Velu ka marrë pjesë në kursin e parë për kalimin në rolin e lartë “Nënkomisar” të zhvilluar në Akademinë e Policisë me rezultate shumë të larta. Kursi u zhvillua në dy faza:
a)Faza e parë e mësimin në distancë, në njësinë përkatëse policore nga 1 prill deri në 28 maj 2004. b)Faza e dytë në Akademinë e Policisë, me një total prej 480 orësh mësimore nga 16 qershori deri në 12 nëntor 2004.

13. Fitimi i gradës “Drejtues i Parë”

Nga aktet e administruara kontatohet se:

- Me urdhër nr.****prot, dt. 29.1.2018, “Për Dhënie e Gradës Policore një punonjësi Policie” në mbështetje të neneve 9, pikat 1 dhe 2, shkronja “b” dhe “ç”, neni 53, pika 2, neni 54 dhe 59 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, nenet 162, pika 5 dhe 172 pika 3 të “Rregullores së Policisë së Shtetit”, në zbatim të urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit: nr. **prot, dt. 11.1.2018 “Për hapjen e procesit të Konkurimit për fitimin e gradës policore “Drejtues i Parë” dhe nr.***prot, dt. 25.1.2018 “Për miratimi e listës emërore të aplikantëve fitues në konkurimin për fitimin e gradës “Drejtues i Parë” si dhe në shkresën nr.****prot, dt. 29.1.2018 të Akademisë së Sigurisë mbi rezultatet e vlerësimit të njohurive në trajnimin për fitimin e gradës “Drejtues i Parë”, urdhërohet që Drejtues Ardi Velu, me detyrë Drejtues në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, përfunduar me sukses programin e trajnimit për fitimin e gradës “Drejtues i Parë”, i jepet grada policore “Drejtues i Parë”, udhëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
- Shkresën nr.****prot, dt. 29.1.2018 nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Akademisë së Sigurisë, mbi rezultatet e vlerësimit të njohurive në

trajnimin për fitimin e gradës “Drejtues i Parë”, ku ka rezultuar se komisioni i përbërë nga 3 anëtar të cilët e kanë vlerësuar të parin me 92 pikë z. Ardi Veliu.

- Urdhër nr. ****prot, dt. 25.1.2018 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit “Për miratimin e listës emërore të aplikantëve fitues në konkurimin për fitimin e gradës Drejtues i Parë” me qëllim zhvillimin e procedurave për trajnimin, dhënien e gradës dhe emërimin në detyrë të aplikantëve fitues në konkurimin për fitimin e gradës “Drejtues i Parë”.

14. Fitimi i gradës “Drejtues Madhorë”

Nga aktet e administruara kontatohet se:

- Vendimi nr. ****prot, dt. 5.2.2018, “Për emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit”, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave, vendosi, z. Ardi Veliu të emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe i jepet grada “Drejtues Madhor”.

Në përfundim Komisioni Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se:

- ✓ *Në zbatim të të gjitha këtyre dispozitave ligjore, të sipër cituara, si dhe në zbatim të të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim dhe për funksionim të ligjeve përkatëse, rezulton e provuar sa më sipër e relatuar dhe dokumentuar, se subjekti z. Ardi Veliu, në funksion të rritjes së tij profesionale, është pajisur në mënyrë kronologjike me gradat profesionale policore përkatëse të cilat ai aktualisht i gëzon në funksion dhe në respektim të ligjeve dhe urdhrave administrative.*

Vlerësimi i tre dokumenteve të përgatitura nga subjekti i vlerësimit:

15. Subjekti i vlerësimit, në zbatim të nenit 46, pika 3, dhe 44, pika 2, e ligjit 12/2018, ka depozituar tre dokumenteve zyrtare të përgatitura në ushtrim të detyrave funksionale si punonjës në Policinë e Shtetit, dhe konkretisht:

- *Anëtar i grupit të punës për hartimin e strategjisë vjetore të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, në vitin 2015, kur ka qënë Zëvendës drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.*
- *Kryetari i Grupit të Punës për hartimin e kurrikulës, kur ka qënë Drejtor i Kolegjit të Lartë Profesional “Kolegji i Policisë”, Akademia e policisë në vitin 2016.*
- *Kryetari i grupit të punës për hartimin e strategjisë së Policisë Rrugore dhe parandalimin e aksidenteve, kur ka qënë Drejtor i Policisë Rrugore, në Departamentin për Sigurinë Publike.*

Nga analiza e tre dokumenteve të përgatitura sa më sipër nga subjekti i vlerësimit Komisioni Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se:

- ✓ *Subjekti i vlerësimit ka njohuri të thelluara mbi legjislacionin që normon kuadrin ligjor të Policisë së Shtetit, si dhe akteve nënligjore në fuqi, që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e Policisë së Shtetit.*
- ✓ *Dokumentet e përgatitura nga subjekti i vlerësimit janë në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore që normojnë kuadrin ligjor për Policinë e Shtetit;*

- ✓ *Dokumentat e përgatitura nga subjekti i vlerësimit janë të qarta, të kuptueshme dhe të strukturuar logjikisht;*
- ✓ *Gjuha e përdorur nga subjekti i vlerësimit në përpilimin e dokumenteve zyrtare është në përputhje me normat dhe etikën profesionale të punonjësit të Policisë së Shtetit;*

Respektimit i rregullave të etikës:

16. Nga verifikimi i dosjes së personelit ardhur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Policinë e Shtetit, (vlerësimet e eprorëve ndër vite), arrihet në konkluzinin se :

- ✓ *subjekti është vlerësuar me pikë maksimale për integritetin, profesionalizmin në kryerjen e detyrave; komunikimin efektiv, qëndrimin konstruktiv, dhe paanshmërinë;*
- ✓ *punon në grup, ndërton marrëdhënie të mira dhe korrekte me kolegët dhe qytetarët;*
- ✓ *është korrekt me detyrën që kryen, korrekt me vartësit, kolegët dhe eprorët;*
- ✓ *tregon objektivitet, korrektësi dhe përpikmëri në kryerjen e detyrave të caktuara;*

17. Subjekti i vlerësimit është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit nga viti 1997 e vazhdim.

- *1997-1998, Kurs kompjuteri në Akademinë e Policisë Turke, Certifikatë;*
- *1.12.1999 - 4.12.1999, Kurs trajnimi për Shërbimet e Policisë së Rendit, Certifikatë;*
- *2.4.1999, Trajnim nga ICITAP, Kursi i Mbikqyrësve për kalimin në policimin demokratik, Certifikatë;*
- *8.9.2000, ICITAP, Kurs i menaxhimit të nivelit të lartë, Certifikatë;*
- *26 - 30.3.2001, IOM dhe Universiteti i Londrës Veriore, Trajnim i trajnerëve kundër trafikimit, Certifikatë;*
- *5.6.2002, UNICEF, Trajnim për oficer policie, Certifikatë;*
- *19 – 20.6.2002, Trajnim i trajnerëve të policisë nga Qendra e të Drejtave të Njeriut, Certifikatë;*
- *19.1.2004 - 25.1.2004, Trajnim i trajnerëve të formimit të punonjësve të policisë së shtetit në rolin bazë, Certifikatë;*
- *13.1.2003, Letër falenderimi e Ministrisë të Rendit Publik, për disiplinë të lartë në përmbushjen e detyrave dhe ndihmë e dhënë për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale, Certifikatë;*
- *19-1.2004-25.1.2004, Certifikatë ku ka përfunduar kursin e trajnimit për trajnues të formimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, në rolin Bazë.*
- *29.4.2004, Kurs trajnimi “Udhëheqja bazuar në parime”, Certifikatë;*
- *18 - 19.5.2004, Trajnim “Planifikimi në Nivel Qarku”, Certifikatë;*
- *10.6.2003, Certifikatë e gjuhës së huaj “Akademic London School”;*
- *12.11.2004, Dëshmi kualifikimi për gradën e lartë Nënkomisar;*
- *16.5.2014, Budapest, Kursi gjashtëmujor i gjuhës angleze, Certifikatë;*
- *23.5.2014, Akademia Ndërkombëtare e Zbatimit të Ligjit Budapest Hungari;*
- *Trajnim në Programin e Zhvillimit në Udhëheqjen e Zbatimit të Ligjit, Certifikatë;*
- *Kurs trajnimi nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar me temë “Për Punën me Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror”, Certifikatë.*

18. Pjesëmarrja në koferenca shkencore, workshope, botime brenda dhe jashtë vendit:

- *Konferenca IADLEST, e Drejtorëve të Shkollave Ligj zbatuese, në Michigan USA, viti 2016;*
- *Konferenca e I-rë Shkencore Ndërkombëtare “Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimimit”, në Tiranë datë 1.11.2016;*
- *Konferenca e Drejtorëve të Policisë të Kryeqyteteve, në Lisbonë-Portugali, viti 2017;*
- *Botime: “Policimi dhe shoqëria, një marrëdhënie ndër aktive afatgjate bazuar në Arsimim dhe Përgjegjësi”, viti 2016;*
- *Botime: “Siguria rrugore: Sfida jonë e përbashkët”, viti 2017.*

Nga sa më sipër Komisioni Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti Ardi Veliu:

- ✓ *Është i aftë profesionalisht për të realizuar detyrat e planifikuara dhe të ngarkuara;*
- ✓ *Është kërkues ndaj zbatimit të detyrave, si dhe ka zgjidhur në kohë detyrat dhe situatat që janë krijuar;*
- ✓ *I kryen detyrat në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore;*
- ✓ *Është i aftë të punojë në mënyrë të pavarur për zbatimin e legjislacionit, për konceptimin e akteve, rregulloreve dhe letërporosive për problemet e luftës kundër krimit të organizuar;*
- ✓ *Trajnimi dhe pajisja me certifikata trajnimi është kryher gjatë karrierës së tij si dhe janë të lidhura me objektin e ushtrimit të funksioneve të tij në detyrat drejtuese.*

19. Gjithashtu gjatë viteve subjekti i vlerësimi z. Ardi Veliu, është shpërblyer për punë cilësore, përkushtim e profesionalizëm, në drejtim të parandalimit, arrestimit dhe goditjes së elementëve kriminal si dhe në mirë menaxhimin e rendit dhe sigurinsë publike, konkretisht:

- *“Për përkushtimin, profesionalizimin dhe aftësitë menaxhuese të treguara, në zbulimin, hetimin dhe ndalimin e autorëve të ngjarjeve të rënda kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe impakt publik”¹.*
- *“Për shpërblimin e disa punonjësve të strukturave të Forcave të Armatosura dhe Policinë e Shtetit, të angazhuar në situatën emergjente të krijuar në disa zona të vendit nga përmbytjet”².*
- *“Për punë cilësore, përkushtimin dhe profesionalizimin e treguara, në realizimin e detyrave të ngarkuara dhe arritjet e larta të dallueshme në raport me periudha paraardhëse”³.*

¹ Urdhër nr.***prot, dt. 10.7.2017 “Për shpërblimin e disa punonjësve të policisë, në drejtorinë Vendore të policisë Tiranë”

² Urdhër nr.***prot, dt. 26.12.2017, “Për shpërblimin e disa punonjësve Forcave të armatosura dhe të policisë së shtetit

³ Urdhër nr.***prot*, dt. 28.12.2017 “Për shpërblimin e disa punonjësve të policisë së shtetit”

- *“Për shpërblimin e disa punonjësve të Policisë së Shtetit”*⁴
- *“Për punë cilësore, përkushtim e profesionalizëm të treguar në realizimin e detyrave për vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike dhe arritjen e rezultateve të larta e të dallueshme në kryerjen e detyrave, në raport me punonjësit e tjerë në shërbim të Policisë së Shtetit”*.⁵
- *“Për punë cilësore, përkushtim, profesionalizmin e treguar dhe për kontributin e dhënë në rritjen e standarteve të rendit dhe sigurisë publike duke arritur rezultate të larta dhe të dallueshme në raport me periudhat paraardhëse, në realizimin e objektivave strategjike dhe programit vjetor të Policisë së Shtetit”*.⁶

Subjekti i vlerësimit Ardi Veliu, ka marrë Medaljen e Nderit me motivacionin:

- *Kontribut i jashtëzakonshëm dhe profesionalizëm i lartë, në ushtrimin e përgjegjësive të parashikuara nga ligji “Për Policinë e Shtetit”, të treguar në operacionet e kërkimit dhe shpërtimit, pas Tërmetit të datës 26.11.2019*⁷.

Në përfundim të hetimit të kryer:

Komisioni Jashtëm i Vlerësimit pas një hetimi të thelluar të kontrollit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit Ardi Zenel Veliu, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e vetëvlerësimit profesional, analizimin dhe verifikimin e të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, arrin në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit Ardi Veliu

- a) *është i aftë, duke treguar cilësi të larta në punë,*
- b) *aftësi në zbatim të përshkrimeve të punës, të përcaktuara për atë funksion,*
- c) *ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut,*
- d) *është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme.*

⁴ Urdhër nr. ***prot, dt. 27.5.2019 “Për shpërblimin e disa punonjësve të Policisë së Shtetit”, në mbështetje të pikës të nenit 102 të Kushtetutës dhe të vendimit nr. 324, dt. 16.5.2019, të Këshillit të Ministrave,

⁵ Urdhër nr. ***prot, dt. 29.5.2019 “Për shpërblimin e disa punonjësve të Policisë së Shtetit”,

⁶ Urdhër nr. ***prot, dt. 28.12.2018 “Për shpërblimin e disa punonjësve të Policisë së Shtetit”

⁷ Urdhër nr. ***prot, dt. 17.12.2019 “Për Dhënie Medalje e Nderit”.

VII. KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa vlerësuese e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, në përfundim të procesit të vlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, Ardi Zenel Veliu, në përputhje me nenin 60 të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollin e figurës;*
- *Konstatohet nivel i lartë në vlerësimin e aftësive profesionale;*

PËR KËTO ARSYE

Trupa Vlerësues e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, bazuar në pikën 7, 8, të nenit 56, të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në mbështetje të shkronjës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit *Ardi Veliu, me funksion Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.*
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
5. *Ky vendim u shpall sot datë 07.02.2020 në Tiranë.*

TRUPA E VLERËSIMIT

Alban Laska
Relator

Mirela Ujkani (Miti)
Kryesuese

Artur Baku
Anëtar